




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.16, datë 31.07.2023



PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK  
SHOQËRISË “VICTORIA HYDROENERGY” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Shkumbin.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Victoria Hydroenergy”, nëpërmjet HEC “Luniku 1” dhe “Luniku 2” me vendndodhje Zalli i Lunikut Bashkia Librazhd Qarku Elbasan sipas së Koncesionit të formës “BOT” Nr.713 Rep., Nr.182/3 Kol., të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues) dhe Subjektit për Qëllime të Veçanta, shoqëria “Victoria Hydroenergy” sh.p.k., (Koncesionari) datë 26.09.2017, për ndërtimin e hidrocentralit “Lunik” si dhe Kontratën Shtesë Koncesioni Nr 1595 Rep., Nr.1027/1 Kol., datë 18.07.2018 “Për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” Nr.713 Rep., Nr.182/3 Kol., për ndërtimin e hidrocentralit “Lunik”.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:



## HEC Luniku 1

Vendndodhja e veprës së marrjes 1 burimi ujqor Përroi Zalli i Lunikut

- $X=524821$ ;  $Y=4574487$ ;  $Z=492$  m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse:  $3.1 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore:  $2.44 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare e muajit më të thatë:  $0.77 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike:  $0.285 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e godinës së Centralit

- $X=525817$ ;  $Y=4571991$ ;  $Z=376$  m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet:  $3.1 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prodhimi vjetor i parashikuar:  $10.560.525 \text{ kwh/vit}$
- Fuqia e instaluar:  $2830 \text{ kwh}$

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH), ku kanali i largimit të godinës së HEC-it Luniku 1 takon trupin ujqor pritës.

- $X=525767$ ;  $Y=4571949$ ;  $Z=375$  m.m.n.d. (KRGJSH)

## HEC Luniku 2

Vendndodhja e veprës së marrjes 1 burimi ujqor Përroi i Zalli i Lunikut

- $X=525758.7$ ;  $Y=4571938.8$ ;  $Z=376$  m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse:  $4.2 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore:  $3.35 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare e muajit më të thatë:  $1.05 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike:  $0.391 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e veprës së marrjes 2 burimi ujqor Përroi i Zalli i Llëngës.

- $X=525944.4$ ;  $Y=4571113.5$ ;  $Z=376$  m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse:  $1.92 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore:  $1.53 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare e muajit më të thatë:  $0.48 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike:  $0.179 \text{ m}^3/\text{s}$

Kaptazhi pas godinës së HEC.Funares burimi ujqor HEC.Lunik 2.

- $X=525659.7$ ;  $Y=4571688.1$ ;  $Z=380$  m.m.n.d. (KRGJSH)

Vendndodhja e godinës së Centralit

- $X=524493$ ;  $Y=4566424$ ;  $Z=274$  m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet:  $6.2 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prodhimi vjetor i parashikuar:  $18,879,691 \text{ kWh/vit}$
- Fuqia e instaluar:  $4600 \text{ kWh}$

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH), ku kanali i largimit të godinës së HEC-it Luniku 2 takon trupin ujqor pritës.



X= 524520; Y= 4566348; Z=271.5 m.m.n.d. (KRGJSH)

Vlera totale e investimit për HEC Luniku 1 dhe HEC Luniku 2:  
1,021,230,884 lekë pa TVSH.

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera. Referuar edhe raportit të VNM-së në periudhën e verës, për shkak të kohës së thatë, të mos të ketë punime.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

